





REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



Komuna e Prishtinës  
Opština Pristina  
Municipality of Prishtina



## MEMORANDUM I MIRËKUPITIMIT

NË MES

KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

DHE

KOMUNËS SË PRISHTINËS

**PILOT PROJEKTI: THIRRJET ELEKTRONIKE TË  
DËRGUARA PËRMES POSTËS ELEKTRONIKE NGA  
GJYKATA TEK KOMUNA E PRISHTINËS**

28 mars 2023

*Me mbështetje nga Projekti KoSEJ III, i përbashkët i Bashkimit Evropian dhe Këshilli të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu, në asnjë rast nuk mund të pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian ose të Këshillit të Evropës.*

Duke pasur parasysh Deklaratën e CEPEJ, "Mësimet e nxjerra dhe sfidat me të cilat përballet gjyqësori gjatë dhe pas pandemisë COVID-19", të datës 10 qershor 2020, e cila nxjerrë në pah se pandemia COVID-19 ka qenë një rast për të paraqitur praktikat inovative emergjente në të gjitha sistemet gjyqësore në Evropë, dhe rekomandon se aspektet e funksionimit tradicional të gjykatës duhet rishikuar për të transformuar gjyqësorin për të ardhmen.

Duke pasur parasysh nenin 69 të Rregullores 02/2020 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Brendshëm të Gjykatave, të datës 29 shtator 2020, që ka të bëjë me "Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit" dhe lejin e zbatimit paralel të nismave të testimit në gjykatë.

Duke pasur parasysh nenin 103, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, e cila lejon që komunikimi të bëhet duke përdorur "postën elektronike".

Duke marrë parasysh të gjeturat e Komisionit për Administrimin e Gjykatave në raportin e tij të datës 3 nëntor 2021, për dërgimin e ftesave gjyqësore me postë ose përmes dorëzuesve, duke theksuar shumë çështje dhe pengesa, si dhe ndikimin negativ financiar për KGJK.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Komuna e Prishtinës, bien dakord bashkëpunimin në vijim:

### **1. Objektivat:**

Pilot projekti ka këto objektiva:

- (1) korigjimi i joefikasitetit të sistemit të dorëzimit të thirrjeve ndërmjet gjykatave dhe palëve për shkak të, dhe në veçanti, çështjeve me adresa postare, duke përdorur postën elektronike për një komunikim të menjëhershëm dhe më të sigurt të informacionit;
- (2) rritja e përdorimit të sistemit informatik për menaxhimin e lëndëve (SMIL) duke gjeneruar automatikisht thirrjet nga sistemi;
- (3) lehtësimi i ngarkesës së punës së gjykatave gjatë lëshimit të thirrjeve, pasi ato do të plotësohen automatikisht, duke përdorur shablonet e SMIL dhe do të dërgohen menjëherë me postë elektronike;
- (4) lehtësimi i pranimit të thirrjeve nga ana e palëve;
- (5) ulja e shpenzimeve të postës për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Për t'i arritur këto objektiva, Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Komuna e Prishtinës pajtohen të fillojnë Pilot Projektin vijues:

Më 1 maj 2023, për një periudhë prej tre muajsh, në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në Departamentin për Çështje Administrative dhe në Divizionin Civil, thirrjet do të gjenerohen automatikisht nga SMIL dhe do t'i dërgohen Zyrës Ligjore të Komunës së Prishtinës me postë elektronike, dhe duke mos përdorur më formatin e rregullt të letrës.

## **2. Veprimet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës**

- KGJK në koordinim me Kryetarin e Gjykatës Themelore të Prishtinës, do të informojë të gjithë gjyqtarët dhe zyrtarët ligjorë/sekretarët në tre departamentet/divizionet më së largu deri më 15 prill 2023 lidhur me Pilot Projektin, dhe do të kërkojë që ata t'i dërgojnë thirrjet Zyrës Ligjore të Komunës së Prishtinës me postë elektronike gjatë periudhës së Pilot Projektit.
- Ekipi i SMIL do të trajnojë gradualisht të gjithë zyrtarët ligjorë/sekretarët dhe gjyqtarët në këto tre departamente/divizione në gjenerimin e thirrjeve nga SMIL dhe në dërgimin e thirrjeve me postë elektronike.

## **3. Veprimet nga Zyra Ligjore e Komunës së Prishtinës**

- Zyra Ligjore e Komunës së Prishtinës do të informojë të gjithë zyrtarët kompetent lidhur me pilot projektin.
- Zyra Ligjore e Komunës së Prishtinës do të njoftojë zyrtarët e saj më së largu deri me datë 15 prill 2023, se duke filluar nga 1 maj 2023, ata do të pranojnë thirrjet nga departamenti/divizioni i lartpërmendur i Gjykatës Themelore të Prishtinës në adresën e postës elektronike [Sektor.Ligjor@rks-gov.net](mailto:Sektor.Ligjor@rks-gov.net).
- Zyra Ligjore e Komunës së Prishtinës do të konfirmojë me zyrtarët e saj se janë duke i pranuar ftesat në adresat e postës elektronike në mënyrë të rregullt.
- Zyra Ligjore e Komunës së Prishtinës do të njoftojë të gjithë zyrtarët e saj për të kontrolluar adresat e tyre të postës elektronike dhe postat e tyre të padëshiruara (SPAM) rregullisht.

## **4. Thirrjet elektronike**

- a. Personat e autorizuar të Gjykatës Themelore të Prishtinës do të gjenerojnë thirrjet automatikisht nga SMIL dhe t'i dërgojnë ato në adresat e postës elektronike të dhënë nga Zyra Ligjore e Komunës së Prishtinës, duke respektuar kërkesat ligjore për afatet e dorëzimit të thirrjeve.
- b. Gjatë dorëzimit të thirrjeve, gjykata do të përdor adresën e postës elektronike të dhënë nga Zyra Ligjore e Komunës së Prishtinës.
- c. Zyrtarët/Avokatët e Zyrës Ligjore e Komunës së Prishtinës, brenda 24 orëve, do t'i dërgojnë një email konfirmimi gjykatës që tregon se ata kanë pranuar thirrjen.
- d. Pas pranimit të konfirmimit nga zyrtari i Zyrës Ligjore të Komunës së Prishtinës përmes emailit, gjyqtari konstaton që thirrja është bërë në mënyrë të rregullt.

## 5. Dispozitat përfundimtare

Me përfundimin e periudhës së lartpërmendur prej tre muajsh, një raport do të përgatitet për këtë pilot projekt.

Për KËSHILLIN GJYQËSOR TË KOSOVËS:  
Kryesuesi

Për KOMUNËN E PRISHTINËS:  
Kryetari

Z. Albert ZOGAJ

Z. Përparim RAMA



*[Signature]*  
Nënshkrimi

*[Signature]*

Nënshkrimi



Data: 28.03.2023

Data: 28.03.2023